



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 479/4 Prot.

Tiranë, më 15.09.2020

V E N D I M

Nr.92, datë 15.09.2020

“Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë të procedurës së lirimit nga shërbimi civil të nëpunësit **, në detyrën “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”, në Bashkinë Rrogozhinë”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së procesit të lirimit nga detyra të nëpunësit *****, i punësuar më parë në pozicionin e punës “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”, në Bashkinë Rrogozhinë,

VËREJ SE:

Shtetasi ***** , nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 479 prot., datë 01.06.2020, ka ngritur disa pretendime për parregullsi dhe shkelje në zbatimin e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, gjatë kryerjes së procesit administrativ të lirimit të tij nga detyra, komunikuar me aktin nr. 238, datë 06.09.2019 “Lirim nga detyra e Drejtorit të Burimeve Njerëzore, *****”, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë.

Për efekt të kryerjes së hetimit administrativ, si dhe për të qartësuar pretendimet mbi problematikën e paraqitur, nëpërmjet shkresës me nr. 479/1 prot., datë 09.06.2020, “Kërkim dokumentacioni në lidhje me lirimin nga detyra, të nëpunësit civil ***** , në pozicionin e punës “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”, në Bashkinë Rrogozhinë”, është vënë në dijeni institucioni i Bashkisë Rrogozhinë, për fillimin e verifikimit të rastit, duke kërkuar njëkohësisht dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e tij.

Bashkia Rrogozhinë me shkresën protokolluar me nr. 479/2 prot., datë 03.07.2020, “Kthim përgjigje”, ka dërguar pranë Komisionerit dokumentacionin që materializon veprimet e kryera, së bashku me një opinion shpjegues të saj.

Duke shqyrtuar përmbajtjen e akteve administrative të vëna në dispozicion nga Bashkia Rrogozhinë, në rastin e lirimit nga shërbimi civil të nëpunësit ***** , në detyrën “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”, në Bashkinë Rrogozhinë, rezulton se:

Nëpunësi ***** është emëruar në pozicionin e punës “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”, në Bashkinë Rrogozhinë, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 1313, datë 15.12.2015, të njësisë së burimeve njerëzore, ku edhe ka përfutur statusin e nëpunësit civil. Ai ka vazhduar të punojë në këtë pozicion pune deri kur me aktin nr. 238, datë 06.09.2019, “Lirim nga detyra e Drejtorit të Burimeve Njerëzore, *****”, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, është liruar nga detyra me arsyetimin se emërimi i tij në detyrë është bërë në kundërshtim me rregullat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga ana e Bashkisë Rrogozhinë, nëpërmjet dokumentacionit të vënë në dispozicion mbrohet opinioni se, emërimi i ankuesit ***** , në pozicionin e punës “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”, me aktin nr. 1313, datë 15.12.2015, të njësisë së burimeve njerëzore në Bashkinë Rrogozhinë, nuk është kryer sipas procedurës së ngritjes në detyrë dhe lëvizjes paralele, parashikuar prej nenit 26, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjë e cila passjell pavlefshmërinë e aktit të emërimit e për pasojë edhe përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit.

Pas shqyrtimit të procedurës së mësipërme administrative ka rezultuar se, fillimisht shtetasi ***** , ka filluar marrëdhënien e punësimit në Bashkinë Rrogozhinë, me aktin me nr. 582 prot., datë 04.08.2015, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin e këshilltarit në kabinetin e kryetarit.

Më pas, është kryer një procedurë për pranim në shërbimin civil me kandidatë nga jashtë, për pozicionin “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse” në Bashkinë Rrogozhinë, ku fitues ka dalë konkurrenti ***** e mbi këtë bazë, me aktin nr. 1313, datë 15.12.2015, të njësisë së burimeve njerëzore, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin e punës “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”, në Bashkinë Rrogozhinë.

Disa vite më vonë, kjo procedurë konkurrimi është analizuar përsëri nga specialistët përkatës të bashkisë dhe është arritur në përfundimin se në këtë rast, emërimi në detyrë i nëpunësit ***** , nisur edhe nga referenca ligjore në aktin e emërimit, është kryer gabimisht sipas procedurës së parashikuar nga neni 22, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe jo sipas procedurës së ngritjes në detyrë ose e lëvizjes paralele, që rregullohet nga neni 26, i ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Kreu V, i vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit,

të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

Sipas tyre, kjo përbën parregullsi të rëndë në kryerjen e procedurës së pranimit në shërbimin civil për një pozicion të nivelit të mesëm drejtues, shkelje kjo e shoqëruar dhe me moskonfirmimin e tij si nëpunës civil në fund të periudhës së provës, megjithëse është kryer me sukses edhe trajnimi tek ASPA. Mbi këtë arsyetim, akti i emërimit të nëpunësit ***** , me aktin nr. 238, datë 06.09.2019, *“Lirim nga detyra e Drejtorit të Burimeve Njerëzore, *****”*, bazuar në nenin 65, të ligjit 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, është konsideruar akt i pavlefshëm dhe mbi këtë bazë është vendosur lirimi i tij nga shërbimi civil.

Në kuadrin e vlerësimit të ligjshmërisë së arsytimit të mësipërm dhe për rrjedhojë edhe të aktit nr. 238, datë 06.09.2019, *“Lirim nga detyra e Drejtorit të Burimeve Njerëzore, *****”*, evidentohen momentet e mëposhtme:

Së pari, pretendimi se akti i emërimit , të ankuesit ***** , nr. 1313, datë 15.12.2015, i njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Rrogozhinë pozicionin e punës *“Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”*, është akt absolutisht i pavlefshëm për shkak të referencës së gabuar ligjore, duke përcaktuar si të tillë nenin 22, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, dhe jo nenin 26, të ligjit në fjalë, e cila është dispozita e saktë që duhej vendosur, nuk mund të përbëjë shkak për të konstatuar pavlefshmërinë absolute të një akti administrativ.

Në këtë rast është e rëndësishme që përmbajtja e procesit administrativ të pranimit në shërbimin civil të ketë qenë e saktë, ndërsa perceptimi jo i saktë ligjor dhe referenca e gabuar ligjore nga ana e specialistëve të burimeve njerëzore, vënia pa shkak e nëpunësit në fjalë në periudhë prove dhe trajnimi i panevojshëm në ASPA, kanë ardhur si rrjedhojë e mungesës së eksperiencës dhe njohurive jo të sakta mbi legjislacionin e shërbimit civil, prandaj këto nuk mund të shërbejnë si bazë për shpalljen e pavlefshërisë absolute të veprimit administrativ të kryer dhe penalizimin e nëpunësit që është subjekt i këtij procesi administrativ.

Në rastin konkret, e gjithë procedura e konkurrimit për pozicionin e punës *“Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”*, në Bashkinë Rrogozhinë, është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, i cili rregullon procedurën e ngritjes në detyrë dhe lëvizjes paralele në shërbimin civil. Kjo, është konstatuar edhe gjatë kryerjes së procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Rrogozhinë, ku Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e planit të miratuar për vitin 2016, ka kryer mbikëqyrje për mënyrën e administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Rrogozhinë, proces i cili ka përfunduar me vendimin nr. 169, datë 30.12.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore,*

Bashkia Rrogozhinë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.

Gjatë mbikëqyrjes, u analizuan të gjitha procedurat e konkurrimit midis të tjerave edhe procedura e konkurrimit për pozicionin e punës “*Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse*”, në Bashkinë Rrogozhinë.

Nga grumbullimi i të dhënave në institucionin e mbikëqyrur ka rezultuar se, procedura e konkurrimit për pozicionin “*Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse*”, është shpallur në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” në datën 01.12.2015, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, Kreu II, pika 2 dhe pikat nga 5 deri në 10;

- Komiteti i Përhershëm i Pranimit është krijuar me aktin nr. 810 prot., datë 25.09.2015, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, pikat nga 2, deri në 5 dhe pikat 8 dhe 9;
- Procesi i verifikimit paraprak, i cili ka për qëllim të sqarojë nëse kandidatët i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, është kryer sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave Kreu IV, pikat 1 dhe 3 dhe në përfundim është publikuar dhe shpallja e fituesve dhe me procesverbalin datë 25.09.2015, është dërguar për publikim në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, në përputhje me Vendimin nr. 143, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, Kreu IV, pika 4, shkronja “b” pikat 5 dhe 6;
- Komiteti i Përhershëm i Pranimit ka kryer vlerësimin (*VKM nr. 143, datë 12.03.2014, kreu IV, pikat nga 7 deri në 15*) dhe me vendimin nr. 1313, datë 15.12.2015, ka shpallur fitues kandidatin *****, i cili është vlerësuar me shumën totale 83 pikë.
- Publikimi i fituesit është shpallur në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, Kreu IV, pika 17.

Në përfundim të procedurave të mësipërme, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e emërimit, të pjesëmarrësit në konkurrim ***** në pozicionin “*Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse*” (*emëruar në shërbimin civil në kategorinë e nivelit të mesëm drejtues, me aktin e emërimit nr. 1313 prot., dt. 15.12.2015*).

Procedura e pranimit në shërbimin civil për nëpunësin ***** në pozicionin e punës “*Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse*”, i emëruar me aktin nr. 1313, datë 15.12.2015, të njësisë së burimeve njerëzore në Bashkinë Rrogozhinë, është vlerësuar nga Komisioneri se, pavarësisht referencave jo ta sakta ligjore, është kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 26, pika 4, të ligjit 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Së dyti, pretendimi se ankuesi më parë ka ushtruar detyrën e “*Këshilltarit të Kryetarit*”, në Bashkinë Rrogozhinë, pra ka qenë i emëruar në një pozicion pune jashtë

shërbimi civil dhe si i tillë nuk mund të merrte pjesë në një procedurë ngritje në detyrë ose lëvizje paralele, siç kërkohet nga neni 26, i ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, të vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, nuk është i bazuar. Duke qenë se kemi të bëjmë me një vend pune të nivelit të mesëm drejtues, në kuptim të nenit 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, është e lejueshme që organi kompetent i menaxhimit të burimeve njerëzore për institucionet e pavarura, mund të vendosë që procedura e rekrutimit të jetë e hapur, në masën që përcakton ligji (jo më shumë se 20 %, të numrit total të pozicioneve të lira) edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë, mjafton që ata të plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e punës. Në rastin konkret rezulton se, konkurrimi për pozicionin e punës “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”, në Bashkinë Rrogozhinë, është bërë me pranim nga jashtë shërbimit civil, duke plotësuar edhe kushtin e 20% të numrit total të vendeve të lira për nivelin e mesëm drejtues.

Së treti, edhe pretendimi se punësimi i nëpunësit *****, nuk është i rregullt, pasi ai nuk është konfirmuar në përfundim të periudhës së provës, siç kërkon dispozita e nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe dispozitat e Vendimit nr.243 dt. 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, i ndryshuar, nuk është i bazuar në ligj.

Periudha e provës dhe konfirmimi në fund të saj, janë koncepte dhe institute që lidhen me procedurën e pranimit në shërbimin civil në pozicione të nivelit ekzekutiv. Në rastin konkret ankuesi *****, është pranuar në shërbimin civil në një pozicion pune të nivelit të mesëm drejtues “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse” dhe si i tillë nuk ka qenë e nevojshme që ti nënshtrohej periudhës së provës. Futja e tij në periudhë prove dhe dërgimi për trajnim në ASPA, kanë qenë rrjedhojë e asaj që u tha dhe më sipër, se njësia e burimeve njerëzore e ka perceptuar dhe referuar gabim nga ana ligjore këtë procedurë pranimi në shërbimin civil. Pasi është dhënë konsulenca e duhur, gjatë kryerjes së procesit të mbikëqyrjes, përfunduar me vendimin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nr.169, datë 30.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Rrogozhinë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, nga ana e njësisë së burimeve njerëzore u rivlerësua se kryerja e periudhës së provës dhe trajnimi në ASPA, nga nëpunësi ***** , kanë qenë të panevojshme, prandaj edhe nuk është vepruar për përmbylljen e periudhës së provës, sipas përcaktimit të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Nisur nga gjithë sa është parashtruar më sipër, arrihet në përfundimin se, akti i Kryetarit të Bashkisë nr. 238, datë 06.09.2019 “Lirim nga detyra e Drejtorit të Burimeve

*Njerëzore, ******”, është nxjerrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe ushtrim jo të ligjshëm të diskrecionit, prandaj në bazë të nenit 109, pika “d” dhe “dh”, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH” , duhet të anulohet nga vetë organi publik që e ka nxjerrë, me një akt të ri me shkrim. Në këtë akt duhet të merren edhe masat për rregullimin e pasojave që ka sjellë ky akt i paligjshëm.

Për këto arsye:

Në zbatim të nenit 15 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” dhe neneve 16, pika 8 dhe 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/ inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë:

VENDOSA:

1. Organi publik, Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të anulojë si të paligjshëm aktin administrativ nr. 238, datë 06.09.2019, për lirim nga shërbimi civil të nëpunësit ***** , me një akt të ri me shkrim.
2. Për rregullimin e pasojave të ardhura nga akti i paligjshëm, të urdhërohet rikthimi i nëpunësit ***** në pozicionin e tij të mëparshëm të punës “Drejtor i Burimeve Njerëzore”, në Bashkinë Rrogozhinë nëse pozicioni është ende i lirë, ose nëse ai është zënë përfundimisht, të sistemohet në një pozicion pune pjesë të shërbimit civil, të të njejtës kategori.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha